


Republika e Kosovës

Republika Kosova


Republic of Kosovo



Komuna Gjilan

Opstina Gnjilane

Municipality of Gjilan



Islamic Relief Kosova

Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari

Direkcija za Poljoprivredu Šumarstvo

Department of Agriculture Forestry

DATE/A:	25.10.2023
PËR/ZA/TO	Për Fermerët e Komunës së Gjilanit
Njoftim	Zyrës së Kryetarit të Komunës Gjilan z. Alban Hyseni
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari –z. Bajram Isufi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Thirrje për Aplikim për grante për fermerët e Komunës së Gjilanit

Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të Islamic Relief- Zyra në Kosovë dhe Komunës së Gjilan-it. Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari, në bashkëpunim me organizatën Islamic Relief hapin thirrjen e aplikimeve për grante të vogla bujqësore.

Ftohen për aplikim të gjithë fermerët e Komunës së Gjilanit, të interesuarit për njërin nga këto grante;

- 1.Serra për ekonomi familjare 91 copë**
- 2.Motokultivatorë 61 copë**
- 3.Pula 50 përfitues (37 pula dhe 3 gjela).**

Aplikimi për Serrë

-Lloji: Serra tunel të zinguar

-Numri i pëfituesëve **91**

-Dimensionet e serrës: **100m²**

Kriteret për përfitimin e një serre.

- 1.Të posedojë tokë të përshtatshme për vendosjen dhe kultivimin e perimeve, jo më larg se 100metra nga shtëpia.
- 2.Të posedojë burim të ujit të përshtatshëm për ujitje të perimeve.
- 3.Të kenë përvojë në kultivimin e perimeve.
- 4.Përfituesit e 2(dy) viteve të fundit nga komuna dhe donatorët tjerë nuk mund të jenë përfitues.
- 5.Përparësi kanë fermerët që veprimtari primare e kanë bujqësinë.

- Përfituesit duhet të participojnë me vlerën 20 % nga vlera e përgjithshme e serrës.

Dokumentet e nevojshme për aplikim për serra:

- 1.Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës (valid).
- 2.Certifikata e bashkësisë familjare
- 3.Fleta poseduese e tokës (nëse pronësia është e parregulluar, atëherë aplikuesi duhet ta dokumentojë me deklaratë të noterizuar ose me certifikatë të lindjes).
- 4.Skicën e parcelës ku do të vendoset serra.

Kriteret për përfitimin e Motokultivatorit (vetëm koka e motokultivatorit)

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë fermerët që merren me:

- 1.Prodhuesit e perimeve në serra mbi 300m².
- 2.Prodhuesit e perimeve në fushë të hapur 2000m².
- 3.Prodhuesit e pemëve të imta mbi 1000m².
- 4.Prodhuesit e pemëve drufrutore mbi 3000m².
- 5.Prodhuesit e fidanëve të pemëve (mbi 4000 fidane).

-Përfituesit duhet të paticipojnë me vlerën 20 % nga vlera e përgjithshme të motokultivatorit.

Dokumentet e nevojshme për aplikim për Motokultivator:

- 1.Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës (valid).
- 2.Certifikaten e bashkësisë familjare.
- 3.Fleta poseduese e tokës (nëse pronësia është e parregulluar, atëherë aplikuesi duhet ta dokumentojë me deklaratë të noterizuar ose me certifikatë të lindjes).
- 4.Skicen e parcelës për të cilën aplikon (serrë, fushë e hapur, pemë të imta, pemë drufrutore dhe kultivues të fidanëve).

Kriteret për përfitimin e Pulave, Pa-Kotec.

Numri i përfitueseve 50

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit.

- 1.Në kushte të barabarta përparësi kanë familjet me fëmijë jetimë dhe nënat vetëushqyese.
- 2.Përparësi do të kenë zonat rurale.
- 3.Të posedojë së paku 0.05ha oborr.
- 4.Të posedojë Kotec për vendosjen e pulave.

Përfituesit e pulave nuk participojnë me 20%.

Dokumentet e nevojshme për aplikim për Pula:

- 1.Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës (valid).
- 2.Certifikaten e bashkësisë familjare.
- 3.Fleta poseduese e tokës (nëse pronësia është e parregulluar, atëherë aplikuesi duhet ta dokumentojë me deklaratë të noterizuar ose me certifikatë të lindjes).
- 4.Dëshmia për rastet sociale (kopje)

Vërejtje: Fermerët mund të aplikojnë vetëm në njërën nga grantet e mësipërme.

Afati për aplikim është i hapur nga data **25.10.2023** deri më **10.11.2023**

Aplikimet të dorëzohen në **Qendrën për Shërbim me Qytetarë.**

Gjilan,25.10.2023

Drejtori i DBP ing. z.Bajram Isufi

